



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
VU644-19-4264-5-3-6/C182
14 Nr. 587/19
Dt. 24.07.2019

KONTRATË SHËRBIMI

Palët kontraktuese :

1. Komuna e Vushtrrisë, si Autoritet Kontraktues, të cilën e përfaqëson: **Saranda Cakaj – Drejtoreshë e Drejtorisë për Prokurim Publik** (në tekstin e mëtejshëm **PORORSITËSI**) , dhe
2. “ Migrant Ing “sh.p.k. & me seli në Podujevë, me NRB dhe NRF: 811282136 dhe NTSH “ Migrant Ing “ me NRB e NRF : 810941965, të cilën e përfaqëson **z. Gresa Blakqori**, në tekstin e mëtejshëm: **KRYESI I PUNËVE/SHËRBIMEVE**,
, janë pajtuar të lidhin këtë kontratë publike për ekzekutimin e shërbimeve dhe / ose punëve, si në vijim: :
Pllakat përkujtime , me numër identifikues:

Prokurimi Nr.	VU644	1	9	42	6	4	5	3	6
Prokurimi Nr.	644	1	9	0	6	8	5	3	6

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë : **Rregullimi i Plakave përkujtime, si dhe ekzekutimi i shërbimeve dhe / ose punëve tjera, në pajtim dhe në sasi si në Specifikimin Teknikë pjesë përbërëse e kësaj Kontrate dhe Kërkesës së Njësies Kërkuese – DKRS-së.**

1.2 Kontrata hynë në fuqi me datën e nënshkrimit, ndërsa ekzekutimi i shërbimeve dhe / ose punëve duhen të përfundohen në afatin, jo më gjatë se **20 ditë pune pas datës së fillimit të ekzekutimit të Shërbimeve dhe / ose Punëve.**

1.3 Vendi i rregullimit të Pllakave përkujtime do të jetë vendi i saktësuar nga Njësia e Kërkesës të Autoritetit Kontraktues.

1.4 Incotermin i aplikueshëm do të jetë **DDP¹** (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **5.867,50€ (pesmijetqindgjashtdhjeteshtatë/50 Euro).**

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale të pagesës pas pranimit teknik të shërbimeve dhe / ose Punëve të ekzekutuara të konfirmuara nga Komisioni i Pranimit në Raportin e Pranimit.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti respektivisht cilësia e punëve dhe / ose shërbimeve duhet, në të gjitha aspektet, të plotësojë specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të punëve dhe / ose shërbimeve.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat respektivisht të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së punëve dhe / ose shërbimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e

res-judicata; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërrprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

14.2 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (c) Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);
- (d) Dhe dokumente tjera të cilat vlerësohen të nevojshme të jenë pjesë e kësaj kontrate.

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.


E hartuar në gjuhën Shqipe në katër origjinale, tri origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik:

Për Autoritetin Kontraktues – Komuna e Vushtrrisë

“ Migrant Ing “sh.p.k. “ &

NTSH “ Migrant Ing “ – Prishtinë

Emri:	Gresa Blakqori	Emri:	Saranda Cakaj
Pozita:	Pronar	Pozita:	Drejtoreshë e Drejtorisë për Prokurim Publik
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	24.07.2019	Data:	24.07.2019
Vula:		Vula:	

Shënim: Te përshkrimi i çmimeve duhet plotësuar vetëm kolonat F dhe G
 Në kolonën F ju duhet të plotësoni duke shkruar normën e TVSH-së, vetëm si numër 0, 8, apo 18, e jo në formatin 0%, 8%-apo-18%, Ndërsa në kolonën G, duhet ta plotësoni me çmimin për njësi me TVSH, po ashtu çmimin duhet ta shkruani me dy decimale pas presëjes dhjetore

Nr.	Përshkrimi i pozicioneve	Mësia Matëse	Sasia	Çmimi për njësi pa TVSH	Norma e TVSH-së në %	Çmimi për njësi (me TVSh)- €	Totali (Pa TVSH)	TVSH	Totali (me TVSH)-€
	Vërejtje: Bazuar edhe në Emërtimin e Dokumentit sasitë e prezantuara janë të Paralogaritura. Punëkryesi duhet t'ia prezantoj përmes Librit Ndërtimorë Vlerat Reale Organit Mbikqyrës për Verifikim dhe Evaluim..Në çmim duhet të përfshihet furnizimi i materialit, instalimi dhe sjelja e produktit në gjendje funksionale. Të gjitha produktet duhet të jenë kualitative dhe ofertesë në ofertën e tij duhet të përfshij certifikatat e kualitetit dhe të standardeve.								
PUNET PËRGADITORE									


1



Përgatitja e hapësirave para fillimit të punimeve, verifikimi i punimeve të parapara dhe organizimi i punimeve në kordinim me pronaret e shëpive dhe org. mbikqyrës									
1	paushall	1.00	677.97	18.00	800.00	677.97	122.03	800.00	
2	Pastrimi i territ. vendosja e shenjëve për organizimi të punimeve	paushall	1.00	762.71	18.00	900.00	762.71	137.29	900.00
PUNET E GRANITIT									
3	Furnizimi me material dhe vendosja e pllakës, së graniti artificial ngjyrë e zezë me dimensione 60x40 x3cm të ankeruara në muret dhe për 4 pllaka duhet të punohen edhe bazometete nga betoni i armuarë me dimensione 0.15x1.10x0.9m' vertikale në lartësi sipas udhëzimeve të org.mbiqyrës, ankerimi i të bëhet me bulona special të cimentuarë në mure. Pllaka duhet të ketë hijezimine shqiponjës dhe testin e gravuara me mbishkrimin (Më 22 maj 1999, forcat ushtarake serbe, këtu ushtuan dhunë dhe gjenocid mbi popullatën e pafajshme, duke lënë të vrarë 67 civil të të gjitha moshave, fëmijë, të rinjë dhe të moshuarë-----LAVDI								
	codë	5.00	296.61	18.00	350.00	1,483.05	266.95	1,750.00	



4	Furnizimi me material dhe vendosja e pllakës , së graniit artificial me ngjyrë të zezë diametër d=50cm dhe trashësi t=3cm të ankuara në trojë të betonit sipas skicës vertikale në lartësi sipas org.mblqyrës, ankerimi i të bëhet me bulona special të cimentuarë në mure . Pllaka duhet të jete egravuarë shqiponjë dhe mbishkrimi si UCK	copë	3.00	296.61	18.00	350.00	889.83	160.17	1,050.00
5	Gërmimi i themelit me dimensione 40x80x100cm , në këtë pozicionë është përfshirë edhe punet betonimi i, armimi i, dhe betonimi i murti me diemnsione 15x80x1,40cm	copë	5.00	63.98	18.00	75.50	319.92	57.58	377.50
6	Furnizimi me material dhe shkurja e emrave dhe mbiemrave të martive të vrarë gjatë luftës së fundit mbi pllakta egzistuse , shkruja duhet të bëhet me gravim në pllakë sipas kërkesë së org. mbikqyrës	copë	60.00	13.98	18.00	16.50	838.98	151.02	990.00
TOTAL:							4,972.46	895.04	5,867.50

U



IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE)	
EMRI I OE:	MEGRANT ING SH.P.K & GRANIT S.HYSENI B.I
EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUESIT TË OE:	GRESA BLAKOORI & GRANIT HYSENI
NËNSHKRIMI:	
DATA:	25.06.2019
VULA:	 

Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

Nr.	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia Matëse	Sasia
	Vërejtje: Bazuar edhe në Emërtimin e Dokumentit sasitë e prezantuar janë të Paralogaritura. Punëkryesi duhet t'ia prezantoj përmes Librit Ndërtimorë Vlerat Reale Organit Mbikqyrës për Verifikim dhe Evaluim..Në çmim duhet të përfshihet furnizimi i materialit, instalimi dhe sjellja e produktit në gjendje funksionale. Të gjitha produktet duhet të jenë kualitative dhe ofertuesi në ofertën e tij duhet të përfshij certifikatat e kualitetit dhe të standardeve.		
	PUNET PERGADITORE		
1	Përgaditja e hapsirave para fillimit të punimeve, verifikimi i punimeve të parapara dhe organizimi i punimeve në kordinim me pronaret e shtëpive dhe org . Mbikqyrës	paushall	1.00

2	Pastrimi i territ , vendosja e shenjave për organizimi të punimve	paushall	1.00
	PUNET E GRANITIT		
3	<i>Furnizimi me material dhe vendosja e pllakës , së granitit artificial ngjyrë e zezë me dimensione 60x40 x3cm të ankeruara në muret dhe për 4 pllaaka duhet të punohen edhe bazametete nga betoni i armuarë me dimensione 0,15x1,10x0,9m' vertikale në lartesi sipas udhëzimeve të org.mbikqyrës, ankerimi i të bëhet me bulona special të cimentuarë në mure .Pllaka duhet të ketë hijezimine shqiponjës dhe testin e gravuara me mbishkrimin (Më 22 maj 1999, forcat ushtarake serbe, këtu ushtruan dhunë dhe gjenocid mbi popullatën e pafajshme , duke lënë të vrarë 67 civil të të gjitha moshave , fëmijë , të rinjë dhe të moshuarë----- LAVDI</i>	copë	5.00
4	<i>Furnizimi me material dhe vendosja e pllakës , së granitit artificial me ngjyrë të zezë diametër d=50cm dhe trashësi t=3cm të ankeruara në trajtë e betonit sipas skicës vertikale në lartesi sipas org.mbikqyrës, ankerimi i të bëhet me bulona special të cimentuarë në mure .Pllaka duhet të jete egravuarë shqiponjë dhe mbishkrimi si UCK</i>	copë	3.00

Numri i Prokurimit: VU644-19-4264-5-3-6 – Titulli Pllakat përkujtimore

5	Gërmimi i themelit me dimensione 40x80x100cm, në këtë pozicionë është përfshirë edhe punët betonimit, armimit, dhe betonimi i murit me dimensione 15x80x1,40cm	copë	5.00
6	Furnizimi me material dhe shkurja e emrave dhe mbiemrave të martirve të vrarë gjatë luftës së fundit mbi pllakë egzistuese, shkurja duhet të bëhet me gravim në pllakë sipas kërkesës së org. mbikqyrës	copë	60.00

OE duhet të ofroj garancion prej jo më pak se 24 muaj, për pllaken dhe për mbishkrimin e pllakës.